

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICES - OPSTINA MITROVICA

0201-052/01-000 1853/25

№ i ligjënatës: 10.01.2025

Drejtori i Punëve Publike dhe Infrastrukturës: Mitrovicë - Mitrovica

RAPORTI I PUNËS

DREJTORIA E SHËRBIMEVE
PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURËS

2024



KOMUNA E MITROVICËS

Raporti i punës për vitin 2024 nga
Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe
Infrastrukturës.

Raporti paraqet punën e DREJTORISË PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE
INFRASTRUKTURË për periudhën Janar-Dhjetor 2024.
Këtu janë përfshirë në mënyrë të përmblodhur aktivitetet e DSHPI-së .

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës (DSHPI) e konsideron publikimin e planifikimit më shumë se sa përmbushje të një detyrimi ligjor dhe institucional. Në vazhdim do t'ju paraqes planin e punës së Drejtorisë që udhëheqi respektivisht Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës në Komunën e Mitrovicës , i cili është një konsiderim real i punës sonë gjatë periudhës Janar-Dhjetor plot ritëm dhe bashkëveprim në mënyren profesionale.

Viti 2024 ka qenë tepër i vështir për shkak të mungesës së stafit profesional ku me një angazhim maksimal me një volum dhe ritëm të madh si në Sektorin e Infrastrukturës ashtu edhe në Shërbimet Publike. Vizioni i përcaktuar në dokumentin strategjik të prioriteteve dhe objektivave të Komunës së Mitrovicës dhe nevojat në territorin e Komunës, na dhanë shtysën kryesore për të punuar më shumë në aspektin ligjor, organizativ dhe profesional të punëve. Kemi planifikim për rritjen e stafit profesional në aspektin inxhiniering ,ku vetëm në periudhën Janar-Dhjetor kemi dy inxhinier ne DSHPI .

PLANIFIKIMI I DREJTORISË PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURË

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës ka ushtruar veprimtarinë konform detyrimeve dhe përgjegjësiave që përcakton Statuti Komunal në realizimin e projekteve në disa rrafshe komplekse dhe shumëdimensionale, me theks të veçantë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, duke intervenuar optimalisht komform pozicioneve të përcaktuara sipas buxhetit komunal. Hartimi i planeve e projekteve konkrete afatshkurtra dhe afatmesme duke përpiluar edhe Rregullore dhe Vendime adekuate të kësaj natyre, duke ofruar shërbime efektive dhe profesionale gjithnjë në të mirë të Komunës dhe qytetarëve të sajë ka qenë dhe mbetet objektiv parësor.

Raporti është përgaditur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastruktures dhe përmbledhe situatën për realizimin e projekteve infrastrukturore si dhe shërbimet e realizura, ky raport paraqet situatën e realizimit të investimeve në periudhën Janar-Dhjetor.

Prioritetet kryesore të drejtorisë për vitin 2024:

- Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në qytet dhe në fshatra:
- Asfaltimi i rrugëve dhe Kubëzimi i rrugëve
- Ndërtimi i trotuareve
- Riparimi i rrugëve
- Ndërtimi i rrugëve me zhavor.
- Përmirsimi i gjendjes së furnizimit me ujë të qytetarëve dhe gjendja e kanalizimeve
- Ndërtimi i rrjeteve të reja të kanalizimit të ujërave të zeza dhe
- Riparimi(debllokimi) i rrjeteve të kanalizimeve atmosferike dhe fekale.
- Përmirsimi i fondit të sipërfaqeve të gjelbruara
- Ndërtimi i shesheve
- Ngritja e sipërfaqeve të gjelbruara.
- Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik
- Përmirsimi i gjendjes së sinjalizimit horizontal dhe vertikal
- Rregullimi i trafikut dhe transporti publik
- Përmirsimi i shërbimeve komunale
- Mirëmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve
- Krijimin e parkingjeve Publike

MISIONI I DSHPI-së

Zbatimin e ligjshmërisë i cili në vete ngërthen;

- Vetë qëndrueshmërinë financiarisht të ofruesve të shërbimeve të dy sektorëve,
- Zbatimin e kritereve ekonomike në rastet e proceseve rregullatore.

PËRGJEGJËSIT E DSHPI-së

Përgjegjësia e DSHPI-së është shumë komplekse e cila kërkon staf të mjaftueshëm dhe profesional gjë e cila kemi ngecje në disa pozicione, eksperiencë të duhur në fushë veprimin e angazhuar dhe më gjerë, mirë të kualifikuar i cili në rastin tonë mund të thuhet se nuk ka qenë i mjaftueshëm gjatë vitit 2024 dhe ka pas shumë kuadër deficitar në aspektin inxhinieringut ku kemi pas shumë mungesa në stafin profesional dhe që shpresoj që gjatë viteve në vazhdim të rrisim edhe kapacitetin e stafit.


Edhe përkundër asaj që u theksua neve kemi arrit ta nxjerrim maksimumin për zbatim të ligjit, politikave dhe të proceseve të cilat duhet të zhvillohen, të cilat janë kompensuar me një organizim të mirë, përgatitje të duhur, ekzekutim dhe monitorim të gjitha fazave dhe etapave nëpër të cilën duhej kaluar për ti përmbush detyrat e punës. Këtë e ka mundësuar në radhë të parë komunikimi i rregullt i brendshëm dhe i ndërsjellë me të gjitha palët e interesit, duke pas si cak një monitorim të duhur, vlerësim të mirë të dhënave të mbledhura, duke krahasuar të njëjtat me objektivat kohore të caktuara.

Nuk është e tepërt të thuhet se stafin e këtij departamenti duhet ta karakterizojnë njohurit shumë dimensionale e specifike, të cilat janë mase të domosdoshme, për përmbylljen me sukses të proceseve të përcaktuara nëpër të cilat ka kaluar dhe po kalon DSHPI.

ORGANIZIMI I DSHPI-së

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, aktivitetet i filloi duke u bazuar në program të punës, në buxhetin komunal dhe objektivat e qeverisë komunale për vitin 2024, si dhe vazhdimin e punëve të planifikuara nga viti i kaluar.


Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë përbëhet nga dy sektorë: Sektori i Shërbimeve Publike dhe Sektori i Infrastrukturës.



Stafi DSHPI-së

Me qëllim të plotësimit të obligimeve ligjore si dhe realizimin e punëve, aktualisht në DSHPI janë të punësuar gjithsejtë 9 shërbyes civil dhe drejtori gjithsej 10 ku prej tyre: 6 meshkuj dhe 4 femra, me këtë përbërje:

- Drejtori ,
- Udhëheqës i Sektorit të Shërbimeve Publike
- Udhëheqës Sektorit të Infrastrukturës dhe 5 zyrtarë .



Statusi i lëndëve në procedurë Administrative

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë në procedurë administrative ka shqyrtuar një numër të kërkesave dhe atë konform LPA dhe sistemit unik të përcaktuar nga MAPL për administratën komunale brenda afatit ligjor janë trajtuar këto lëndë si në tabelë:

| Gjithësejtë kërkesa: | Të Aprovuara | Të Refuzuara | Në Proces |
|---------------------------------|-------------------------|-------------------------|------------------|
| 584 | 247 | 172 | 165 |

Projektet Kapitale viti 2024 – Planifikimi

| PLANIFIKIMI I BUXHETIT PER PROJEKTET KAPITALE 2024 NGA GRANTI DHE TE HYRAT VETANAKE | | | | |
|---|-------|--|------------|------------|
| Nr. | Kodi | Përshkrimi | GRANT | THV |
| 1 | 45797 | Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kqiq | // | 80,000.00 |
| 2 | 45866 | Ndërtimi i rrugëve në fshatin Lushtë | 40,000.00 | // |
| 3 | 45875 | Ndërtimi i rrugëve në fshatin Koshtovë | 40,000.00 | // |
| 4 | 45889 | Ndërtimi i rrugëve në fshatin Vaganicë | 70,000.00 | // |
| 5 | 45897 | Ndërtimi i rrugëve në Stan Terg | 40,000.00 | // |
| 6 | 45907 | Ndërtimi i rrugëve në fshatin Bajgorë | 40,000.00 | // |
| 7 | 45909 | Ndërtimi i rrugëve në fshatin Vllahi | 50,000.00 | // |
| 8 | 47084 | Ndërtimi irrijetit të Ujësellsve | // | 50,000.00 |
| 9 | 47210 | Ndërtimi i rrugëve në fshatin Zasell | 40,000.00 | // |
| 10 | 47220 | Ndërtimi i rrugëve në Tunelin e Parë | 40,000.00 | // |
| 11 | 47234 | Ndërtimi i rrugëve në fshatin Shupkovc | 40,000.00 | // |
| 12 | 51930 | Ndërtimi i rrugës Ali Zeneli | 190,000.00 | 200,000.00 |
| 13 | 51935 | Ndërtimi i rrugës Lah Nimani dhe Evlia Qelebia | 242,453.00 | 200,000.00 |
| 14 | 51938 | Rregullimi i shtratit të Lumit Ibër | 100,000.00 | 100,000.00 |
| 15 | 51939 | Rregullimi i shtratit të Lumit Sitnica | // | 20,000.00 |
| 16 | 52617 | Ndërtimi i rrugës Dëshmoret e Kombit - Shipol | 228,205.00 | 200,000.00 |
| 17 | 52921 | Ndërtimi i rrugëve në lagjen Ilirida | // | 170,000.00 |
| 18 | 52922 | Ndërtimi i rrugëve në lagjen Bair | // | 50,000.00 |
| 19 | 52923 | Ndërtimi i rrugëve në lagjen Shipol | 40,000.00 | // |
| 20 | 52925 | Ndërtimi i rrugës në fshatin Zhabar | // | 50,000.00 |

| | | | | |
|----|-------|--|---------------------|---------------------|
| 21 | 52926 | Ndërtimi i rrugëve në fshatin Gushavc dhe Vinarc | 80,000.00 | // |
| 22 | 52927 | Ndërtimi i rrugëve në fshatin Broboniq | 81,711.00 | 80,000.00 |
| 23 | 52948 | Ndërtimi i rrugëve në Lagjen Ura e Gjakut | 52,000.00 | 50,000.00 |
| 24 | 52992 | Rregullimi i Bulevardit Isa Boletini | 110,000.00 | 20,000.00 |
| 25 | 53028 | Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe pusetave në Shalë të Bajg. | 70,000.00 | // |
| 26 | 53390 | Asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve Vllahi, Melenicë, Bajgorë | 80,000.00 | // |
| 27 | 53396 | Rregullimi i trotuareve me kubëza në Qytet, Zhabar, Koshtove | 70,000.00 | // |
| 28 | 54785 | Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik në Shalë të Bajgorës | 70,000.00 | // |
| 29 | 54789 | Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve në Qytet dhe Fshatra | 40,000.00 | // |
| 30 | 54791 | Asfaltimi, Ripar. dhe rregullimi i rrugëve në Qytet dhe Fshatra | 40,000.00 | // |
| | | Totali | 1,894,369.00 | 1,270,000.00 |

Procedurat e iniciuara të tenderit janë si:

- Ndërtimi i rrugëve në Lagjen e Shipolit
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Vaganicë
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Zhabar
- Ndërtimi i rrugëve në lagjen Ura e Gjakut
- Asfaltimi i rrugëve në fshatra dhe qytet
- Ndërtimi i rrugëve dhe tretuareve në qytet dhe fshatra
- Ndërtimi i rrugëve në lagjen Bair
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Zasell
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Shupkofc
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Koshtove
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Lushte
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Tunel I Pare
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Stan Terg
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Bajgore
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Vllahi

Projektet në vazhdim të cilat kane perfunduar kete vite ose janë në fazen e fundit për implementim nga vitet paraprake janë si:

- Rregullimi dhe riparimi i rrugës Mbretëresha Teutë-
- Ndërtimi i urës te Liqeni Artificial
- Rregullimi i shtratit të lumit Ibër
- Ndërtimi i rrugëve në Lagjen e Shipolit
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Broboniq
- Rregullimi i sheshit “Adem Jashari”; sheshit “Mehë Uka” dhe sheshit “Isa Boletini”
- Ndërtimi i rrugëve Agim Ramadani dhe Bislim Bajgora bashkëfinancim me MMPHI
- Ndërtimi i rrugës Dëshmorët e Kombit-Shipol
- Ndertimi I rruges ne fshatin Kqiq
- Ndertimi I rruges Ali Zeneli
- Ndertimi I rruges Lah Nimani
- Ndertimi I rruges ne lagjen Ilirida
- Ndertimi I rruges ne fshatin Zhabar
- Ndertimi I rruges ne lagjen Bair
- Ndertimi I rruges ne fshatin Vaganice
- Blerja e semaforeve,paisje sinjalizuese dhe ndriqese ne qytet

- Rregullimi I tretuareve me kubeza betoni ne Qytet,Zhabar dhe tek liqeni Akumulues
- Mirembajtja verore dhe dimrore e rrugeve
- Mirembajtja,ngritja dhe revitalizimi I siperfaqeve te gjelbruara dhe parqeve ne qytet.
- Larja,fshirja dhe mirembajtja verore e rrugeve ne qytetin e Mitrovices
- Mirembajtja e ndriqimit publik ne qytetin e Mitrovices
- Shenjzimi Horizontal dhe Vertikal ne qytetin e Mitrovices

Raport financiar për vitin 2024

Kategoria Mallra dhe Shërbime

Granti

Të alokuara - 505,000.00 €

Të shpenzuara - 504,844.66 €

Të zotuarat - 124.50 €

Të lira - 30.84 €

Te Hyrat Vetanake

Të alokuara – 300,000.00 €

Të Shpenzuara – 296,745.54 €

Të zotuarat – 3.152.89 €

Të lira – 101.57 €

Shpenzimet Komunale

Të alokuara – 151,100.00 €

Të Shpenzuara –103,990.40 €

Të zotuarra – 47,009.60 €

Të lira – 0.00 €

Investimet Kapitale

Nga Granti

Të alokuara – 1,874,369.00 €

Të realizuara – 1,477,604.33 €

Të zotuarra – 383,714.20 €

Të lira – 13,050.47 €

Të Hyrat Vetanake

Të alokuara – 1,270,000.00 €

Të realizuara – 503,818.26 €

Të zotuarra – 220,854.62 €

Të lira – 545,327.12 €

Mjetet e Bartura

Të alokuara – 453,874.27 €

Të realizuara – 373.423.17 €

Të zotuarra – 80,451.08 €

Të lira – 0.00 €

Total Buxheti

Te alokuara – 4,589.157.84 €

Te shpenzuara – 3,260.426.36 €

Te zotuarra – 735,306.89 €

Te lira – 593,424.59 €

Ndriçimi Publik - Mitrovicë 2024

Mirëmbajtja e ndriçimit publik në periudhën Janare – Gusht 2024 është paraqitur në tabelën më poshtë:

| Nr. | Përshkrimi | Lokacionet |
|-----|--------------------------------|-------------------------|
| 1 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Shalës |
| 2 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Ukshin Kovaqica |
| 3 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Ramadan Kelmendi |
| 4 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Artim Jashari |
| 5 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Tjegullore |
| 6 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Esat Meholli |
| 7 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Bajram Curri |
| 8 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Vaganicë |
| 9 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Hakif Bislimi |
| 10 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Sami Gashi |
| 11 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Liqeni Akumulues "Ibri" |
| 12 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Ahmet Selaci |
| 13 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Shemsi Ahmeti |
| 14 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Driton Veliu |
| 15 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Ardiatiku |
| 16 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Dëshmorët e Kombit |
| 17 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Ferki Aliu |
| 18 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Evlia qelebia |
| 19 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Avni Shabani |
| 20 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Besim Nuka |
| 21 | Mirëmbajtje e ndriçimit publik | Marsi 81 |

| | | |
|----|-------------------------------|-------------------------|
| 22 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Beteja e Koshares |
| 23 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Sadullah e Avni dibrani |
| 24 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Sheshi Isa Boletini |
| 25 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Ilaz Kodra |
| 26 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Deshmrët e Vaganicës |
| 27 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Lumi |
| 28 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Pajazit Boletini |
| 29 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Xhevat Isufi |
| 30 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Ilmi Emini |
| 31 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Jashar Boletini |
| 32 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Hoxhë Hasan Tahsini |
| 33 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Murat Emini |
| 34 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Sheqir Avdiu |
| 35 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Broboniq |
| 36 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Ramiz Beqiri |
| 37 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Ardhmëria |
| 38 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Lumi |
| 39 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Pajazit Boletini |
| 40 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Xhevat Isufi |
| 41 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Ilmi Emini |
| 42 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Jashar Boletini |
| 43 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Hoxhë Hasan Tahsini |
| 44 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Murat Emini |
| 45 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Sheqir Avdiu |
| 46 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Broboniq |
| 47 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Ramiz Beqiri |

| | | |
|----|-------------------------------|---------------------------|
| 48 | Mirmbajtje e ndriqimit public | Ardhmëria |
| 49 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Marie Shllaku |
| 50 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Mulla Osmani |
| 51 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Ago Agaj |
| 52 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Vataj |
| 53 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Demali Aliu |
| 54 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Gucia |
| 55 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Zahir Pajaziti |
| 56 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Hamëz Jashari |
| 57 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Kolonia |
| 58 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Stacioni Policor-Suhodoll |
| 59 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Fadil Deliqi |
| 60 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Qendra Zejtare |
| 61 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Adem Jashari |
| 62 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Ali Pash Tepelena |
| 63 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Adem Voca |
| 64 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Elez Begu |
| 65 | Mirmbajtje e ndriqimit publik | Lek Dukagjini |



MIREMBAJTJA E SHENJEZIMIT HORIZONTAL DHE VERTIKAL,



| Pershkrimi | Shenjat | njesia | sasia | Lokacioni |
|---|---|---------------|--------------|---|
| Shenjezimi vertikal | Njoftimit | cope | 1 | Rashan |
| rr.Mbretresh Teutë | Shtegu per biqikleta | m' | 2000 | rr.Mbretresh Teutë |
| rr.Liqeni | Shtegu per biqikleta | m' | 3000 | rr.Liqeni |
| rr.Selman Vojvoda (ura e Gjakut) | Shtegu per biqikleta | m' | 136 | rr.Selman Vojvoda (ura e Gjakut) |
| Nëper Qytet,fsh.RASHAN ,SH.Ahmet,Driton Veliu | Vendndalje e autobusave | copë | 22 | Nëper Qytet,fsh.RASHAN ,SH.Ahmet,Driton Veliu |
| Shenjezimi vertikal | Sinjalizim vertikal | copë | 38 | Rashan |
| Shenjezimi vertikal | Parking per persona me aftesi te kufizuar | copë | 4 | Bedri Gjina , Nexhip Draga ,Tek trjegullorja |
| Nëper qytet | riparime të shenjave | copë | 32 | Nëper qytet |
| Pengesa ne rrugë | | m' | 12 | Shupkovc |
| Nëper qytet | riparime të shtyllave | copë | 18 | Nëper qytet |

Mirëmbajtja e hapësirave gjelberuese








Larja, fshirja dhe mirembajtja verore e rrugeve ne qytetin e Mitrovices

| Nr. | Emërtimi i rrugëve dhe shesheve që duhet pastruar | Lokacioni | Gjatësia m | Gjerësia m | Rruge | Trotuare |
|-----|--|--|---------------|---------------|--------|----------|
| 1 | Bulevardi Mbretëresha Teuta & Isa Boletini | Prej Urës së Gjakut deri te Ura e Ibrit | 1476 | 24 | 22140 | 13284 |
| 2 | Artim Jashari & Safet Boletini | Prej Stacionit të autobusëve deri te sh.f." Migjeni " | 931 | 10 | 6517 | 2793 |
| 3 | Driton M.Veliu | Prej "Migjeni " deri fabrika " 1.Maji " | 500 | 20 | 8000 | 2000 |
| 4 | Ukshin Kovaqica | Prej sh.f."Migjeni "deri te tregu I gjelbërt | 1089 | 15 | 9442.5 | 6892.5 |
| 5 | A.Selaci ,M. e Kombit, Xh. Deva dhe Pajazit Boletini | Prej Ures se Lushtes deri te bunari | 950 | 10 | 6650 | 2850 |
| 6 | Hasan Prishtina | Prej DPP-së deri tek "Adriatiku " | 140 | 11 | 1050 | 490 |
| 7 | Sheshi Skënderbeu | Prej Adfriatikut deri te rr. . Xhader Deva | 100 | 0 | 0 | 1130 |
| 8 | Sheshi i Lirisë m ² | Te Xhamia Isa Bej | | | 0 | 3500 |
| 9 | Bulevardi "Shemsi Ahmeti " & " Brigada 141 Mehe Uka | Prej Sh. F. "Andon Zako Çajupi deri tek Varezat ortodokse | 1500 | 22 | 22500 | 10500 |
| 10 | Sheshi I qytetit m ² | | .0 | 0 | 0 | 19056.9 |
| 11 | Bedri Gjina & Adem Voca | Prej KK-së deri tek stadionii vjeter | 554 | 11 | 4597 | 1497.36 |
| 12 | Fatime Hetemi | kryqezimi I rruges qe lidh Bedri Gjinen me M. Teuta | 100 | 10 | 700 | 300 |
| 13 | UÇK-Ibrahim Popovci | Prej udhekryqi te gjimnazi deri deri te rruga per në Frasher | 1143 | 9 | 8000 | 2286 |
| 14 | Selman Vojvoda & Deshmoret e Kombit | Prej Urës së Gjakut deri te Fabrika e Ujit në Shipol | 3250 | 11 | 22800 | 3250 |
| 15 | Agim Ramadani Katana & | Prej udhkryqi te bunari deri | 672 | 8.5 | 4368 | 1344 |

| | Fari Noli te dielli | te Intereksi dhe te Dielli | | | | |
|---------------|-------------------------|--|----------------|--------------|------------------|-----------------|
| 16 | Muhamet Gashi | Prej sh.f. Ismajl Qemajli deri te rr. Fadil Deliqi | 500 | 6 | 3000 | 0 |
| 17 | Evlia Çelebia | Prej shtepis se Xhafer Deves deri te sh.f. Eqrem Qabej | 450 | 4.5 | 2025 | 0 |
| 18 | Bislim Bajgora | Prej Laures se trenit deri te interesksi | 535 | 11.5 | 5082.5 | 1070 |
| 19 | Ramadan Kelmendi | Prej Unitetit dri te rrethrotullimi te Bamexi | 890 | 13.2 | 6780 | 5050 |
| 20 | Avni Shabani | Prej Shet. Agim Hajrizi deri te sh.f. Eqrem Qabej | 145 | 4.5 | 652.5 | 0 |
| 21 | Miran Hajra | Kryqezimi I rruges qe lidh Adem Vocen dhe Mexhit Draga | 190 | 8.5 | 1045 | 570 |
| 22 | Kemajl Ataturku | Prej shtepis se shendetit deri te Bulev. Shemsi Ahmeti | 167 | 8.75 | 1294.25 | 167 |
| 23 | Deriton Veliu -Suhodoll | prej Aqua Parkut deri te rruga Liqeni | 430 | 10 | 2365 | 1935 |
| 24 | Rruga Liqeni | Prej Ujsjellsit deri te Res. Ujvara | 1500 | 11.5 | 11250 | 6000 |
| 25 | Snetitorja te Liqeni | | 1500 | 6 | 0 | 9000 |
| 26 | Lah Nimani | Prej Halles se sporteve deri te rruga Avni Shabani | 153.5 | 19.95 | 1834.33 | 1228 |
| Totali | | | 18865.5 | 265.9 | 152093.08 | 96193.73 |



Largimi i mbeturinave dhe matrialeve te forta –deponi e egra :





“Ndërtimi i URËS te Liqeni Artificial – Marrëveshje Mirëkuptimi KOMUNA – MZHR dhe DEMOS” Urë tek Liqeni akumulues





Ndertimi i rrugëve me kubza në Shipol të Mitrovicës





**“ Rregullimi dhe riparimi i rrugës Mbretëresha Teutë në Mitrovicë
bashkefinancim me MAPL dhe DEMOS“**






“ Ndërtimi i rrugës Lah Nimani në qytetin e Mitrovicës “









“ Ndërtimi i rrugës Ali Zeneli në qytetin e Mitrovicës “














KOMUNA E MITROVICËS SË JUGUT
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURË


ASFALTIMI I RRUGËS "ALI ZENELI"

“ Rregullimi i shtratit të Lumit Iber “









“ Ndërtimi i rrugëve ne fshatin Vaganice dhe Broboniq “

